



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**A nr. 280/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës (PDAK) dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Partia e Ashkalinjëve për Integrim (PAI) dega në Ferizaj, për shkak të dëmtimit të posterave publike, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës (PDAK) dega në Ferizaj .

**Arsyetim**

Me datën 18.10.2013, PDAK-ja, ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendon se, me datën 16 dhe 17 tetorë 2013, në mëngjes rreth orës 9:00 – 11:00 në lagjen “Sallahane” në afërsi të shtabit të PAI-së në Ferizaj, nga njëri militantë dhe të afërm të kandidatëve të PAI-së, i kanë dëmtuar posterët e PDAK-së. Parashtruesi i ankesës në cilësi të provës ka bashkangjitur dhjetë fotografi si dëshmi .

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik PAI me datën 16.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 19.10.2013 deri në ora 14:00.

PZAP-i e pranoi përgjigjen e kërkuar nga PAI-ja, sipas afatit të caktuar, dhe ka shtuar se në përgjigje të ankesës me datë 23.10.2013 PAI-ja, ka theksuar se, ankesa e parashtruar nga PDAK-ja është krejtësisht e pa bazë andaj ka propozuar që e njëjta të hudhet si e pa bazë. Për më tepër ka shtuar se, ankesa e parashtruar është një paragjykim me fotografi, gjoja se ky person në foto i ka dëmtuar posterat e PDAK-së gjë që nuk është aspak e vërtetë dhe është shpifje me qëllim të dëmtimit të subjektit tonë .Me tutje ka theksuar, personi në foto është duke hyrë në zyre të PAI-së dhe nuk mund të thuhet apo dëshmohet ndryshe veç se fotografim rrugorë të kalimtarëve të rastit apo të strukturës politike të PAI-së .Pra e vërteta e gjithë kësaj foto është se ky djalosh është djali i kandidatit Naser Emini dhe e gjithë shkresa është e shpifur dhe e pa vërtet . Personat që janë cekur si dëshmitarë, Qazim Rahmani, Besart Jashari dhe Hamdi Maliqi që të tre janë në listën garuese dhe në spote televizive, prandaj PAI ka shtuar se këta nuk mund të mos thonë ndryshe veëm por ashtu siç i urdhëron PDAK-ja, prandaj këta persona nuk mund të merren në asnjë mënyrë si dëshmitar .

PZAP-i, pasi që administroi shkresat e lëndës gjeti se:

### **ankesa është e pabazuar**

Me ankesën e parashtruar nga PDAK-ja, pretendohet se militantët e subjektit politik PAI, me datën 16 dhe 17 tetorë 2013 në mëngjes rreth orës 09:00 – 11:00 në lagjën “Sallahane” në afërsi të shtabit të PAI-së në Ferizjaj i kanë dëmtuar posterat e kandidatit nga radhët e PDAK-së.

PZAP-i, gjeti se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë, ngase dëshmitë e ofruara nga parashtruesi i ankesës nuk janë objektive, me të cilat vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar, për arsye se nga fotografitë e ofruara si prova nuk janë të qarta dhe bindëse që e vërtetojnë një shkelje të veprimeve të ndaluara të parapara sipas dispozitave të LZP-së.

PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu administruar si provë relevante nga fotografitë e paraqitura si dëshmi bindëse, prandaj ankesa vlerësohet si e pa bazë duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, neni 3.6 pika b), dhe në kuptim të nenit 115.1 lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë**

A nr. 280/2013 më datën 25.10.2013.

**Kryestuesi i Panelit**  
**Muhamet Rexha**



***Këshillë Juridike:*** PZAP-i nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*